



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr.325 /2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Partisë së Ashkalive për Integrim (PAI), dega në Ferizaj, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), dega në Ferizaj, për shkak të moslajmërimit për mbajtjen e tubimit publik, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Partia e Ashkalive për Integrim (PAI), dega në Ferizaj.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 23.10.2013, nga subjekti politik PAI dega në Ferizaj, me të cilën pretendohet se më datë 08.10.2013 drejtuesit e PDAK-së në fshatin Dubravë në shtëpinë e z. Enver Goliqi, kanë mbajtur fushatë zgjedhore, duke mos e lajmëruar atë më herët në KKZ dhe policin e Kosovës. Parashtruesi i ankesës pretendon se fushata në fjalë nuk i ka respektuar rregulloret mbi zgjedhjet pasi që si e tillë nuk është lajmëruar në KKZ.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur një fotografi me tekst si dëshmi.

PZAP-i, e informoi subjektin politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me datë 24.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 25.10.2013, në ora 12:00.

PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK) sipas afatit të caktuar, ku subjekti politik PDAK mohon pretendimet e ankuesit dhe thekson se akuzat në drejtim të subjektit tonë politik për fushatën që thuhet se është mbajtur më datë 08.10.2013 dhe pa lajmërim të policisë dhe KKZ-së, deklarojmë se fushata është mbajtur më 12 tetor dhe ne e kemi lajmëruar edhe Policin edhe KKZ-në. Përgjigjes tonë ia kemi bashkangjitur edhe formularin e njoftimit të tubimeve publike që posedon KKZ-ja dhe policia.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

**ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore të palës ankuese PZAP-i, i konsideron se janë të pa bazuara dhe të pa argumentuara, sepse nga dëshmia e ofruar nga parashtruesi i ankesës nuk është dëshmi bindëse me të cilën vihet në dyshim se është kryer një veprim i ndaluar dhe nuk është e mjaftueshme për të vërtetuar shkeljen e supozuar. Andaj PZAP-i ,konstatoi se një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu vërtetuar, prandaj duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa në Prishtinë**

Anr. 325/2013 më datën 25.10.2013



**Kryesuesi i Panelit**

**Nehat Idrizi**

***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*